



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA JURIDIKE, PROKURIMEVE DHE PRONAVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 01, datë, 07.01.2025

**“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË,
SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE”**

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit në mbledhjen e Këshilit Bashkiak të datës, ____ .01.2025

PROPOZON

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare të apartamenteve në treg, për efekt subvencionimi të qirasë:

a) Për apartament të tipit “Garsonierë”	6,000	lekë/muaj
b) Për apartament të tipit 1+1	12,000	lekë/muaj
c) Për apartament të tipit 2+1	15,000	lekë/muaj
d) Për apartament të tipit 3+1	18,000	lekë/muaj

- Miratimin e vlerës të qirasë vjetore për vitin 2025, për apartamentet e programit “Banesë sociale me qira”, me vlerën 88 lekë/m² në muaj;
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, Bashkia Dibër;
- Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e institucionit të Prefektit, Qarku Dibër;

Përgjegjës i Sektori të Administrimit të

Pronave dhe Strehimit

Gazmend Miftari

Drejtori Juridik

Ismet Saraçi



Datë 07.01.2025

**RELACION SHPJEGUES
PËR PROJEKT - VENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË,
SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, shpenzimet mesatare referuar shkreses së MEKI nr. 12836 Prot., datë 13/11/2024, adresuar Bashkisë Dibër, “Për vlerësimin e nivelit të të ardhurave mesatare të familjeve”, të dhëna që do të përdoren për vlerësimin e nivelit të të ardhurave të familjeve sipas nenit 2, pika 45 ligjit “Për strehimin social”.

Bazuar nenit 73, gërma dh, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar ku citohet:

dh) Brenda muajit janar të çdo viti, paraqet pranë ministrit përgjegjës për strehimin kërkesën për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji, nga fondet e buxhetit të vitit korrent, shoqëruar me informacionin, i cili përmban:

- i) numrin e familjeve të regjistruara për t’u trajtuar me programet sociale të strehimit;
- ii) numrin e familjeve që janë trajtuar brenda një viti;
- iii) të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore, që do të përdoren për programet sociale të strehimit.

Me qëllim përcaktimin e qirasë mesatare të apartamenteve ne treg për strukturën që i takon familjes dhe thirrjes së përvitshme që hapet nga Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit mbi fondet për subvencionimin e qirasë për vitin 2025, ku për të përfutur fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të plotësojë kushtet ligjore si më poshtë:

- të ketë miratuar nivelin e qirasë mesatare në treg të lirë, sipas strukturave të apartamenteve, me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Kërkohet të jepet miratimi për miratimin e nivelit të qirasë mesatare të apartamenteve në treg, për efekt subvencionimi të qirasë dhe miratimin e vlerës të qirasë vjetore për vitin 2025, për apartamentet e programit “Banesë sociale me qira”.

Spektori i Pronave dhe Strehimit

Juriste
Xhesika Rama



Specialist
Mentor Bitri



Përgjegjës
Gazmend Miftari

